

## “MBI ANALIZËN VJETORE PËR VITIN 2023 TË KLSH-së”

Në zbatim të urdhrorit të Kryetarit të KLSH-së nr.2, datë 10.01.2024, gjatë muajit shkurt, në mjediset e KLSH-së zhvilluan analizat vjetore për punën e kryer gjatë vitit 2023, Departamentet, drejtoritë dhe sektorët e KLSH-së, ku morën pjesë të gjithë punonjësit e KLSH-së. Këto analiza kanë për qëllim reflektimin mbi përmbushjen e objektivave strategjike dhe vjetorë të institucionit si dhe punës audituese të audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit si dhe gjenerimin dhe propozimin e ideve të reja mbi përmirësimin e punës audituese. Vlen të theksohet se viti 2023 përkon njëkohësisht edhe me vitin e parë të Strategjisë 5 vjeçare të Zhvillimit të KLSH, 2023-2027. Në këtë kontekst, mori rëndësi të veçantë realizimi i detyrave që rrjedhin nga dokumentet strategjike dhe metodologjike të KLSH, duke mbajtur në fokus, garantimin e zhvillimit të veprimtarisë audituese në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit, praktikat më të mira të fushës, menaxhimin efektiv të burimeve njerëzore, realizimin e veprimtarisë audituese të orientuar drejt vlerësimit të riskut sipas sistemeve, si dhe rritjen e cilësisë së punës audituese dhe profesionalizmit.



Ky aktivitet nisi me raportimin dhe analizën e veprimtarisë së drejtorive dhe sektorëve mbështetës, (më datë 09.02.2024), ku nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm u analizua realizimi i objektivave si dhe sfidat me të cilat njësitë përkatëse janë përballur gjatë vitit që la pas. Njëkohësisht u parashtruan edhe nevojat me qëllim përmbushjen e objektivave përgjatë vitit 2024. Më datë 12.02.2024, realizuan analizat e aktivitetit vjetor: Departamenti i Metodologjisë, Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit Profesional, Departamenti Juridik; Drejtoria e Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë së Auditimit dhe Etikës dhe Drejtoria e Auditimit të Brendshëm, ku përveç raportimit mbi realizimin e indikatorëve përkatës, u diskutuan dhe problematika të hasura përgjatë proceseve të ndryshme audituese, për çështje që lidhen me përmirësimin e mëtejshëm të punës audituese.

Më datat 13.02-16.02.2024 zhvilluan aktivitetin e analizës vjetore 6 departamentet e auditimit, të cilat jo vetëm analizuan rezultatet e auditimit, nga pikëpamja statistikore me qëllim arritjen e objektivave vjetore, por njëkohësisht sollën shembuj konkret të gjetjeve dhe rekomandimeve për auditime me ndikim në fusha të ndryshme (sipas llojit të departamentit).

Analiza vjetore e KLSH edhe këtë vit diktoi nevojën për optimizimin e aftësive profesionale dhe njohurive inovative mbi standardet ndërkombëtare të fushës, për të gjithë trupën audituese dhe personelin mbështetës nëpërmjet punës së përbashkët, bashkëpunimit të vazhdueshëm më

SAI-et homologe, pjesë e komunitetit INTOSAI dhe EUROSAI, trajnimeve të organizuara së brendshmi dhe së jashtmi me qëllimin për të zhvilluar më tej kuptueshmërinë e njohurive audituese, që nxisin veprim dhe prodhojnë rezultate cilësore.